

RAPORT PËRMBLEDHËS

Mbi zbatimin e buxhetit për vitin 2021

I nderuar zoti Kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

Të nderuar deputetë,

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të detyrimeve kushtetuese i paraqet Kuvendit, Raportin e konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2021, si një sintezë e treguesve dhe veprimtarisë kundrejt objektivave të paracaktuara në kuadër të menaxhimit të financave publike nga institucionet e qeverisjes së përgjithshme, si dhe mendimin për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para miratimit nga Kuvendi.

Në hartimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit të konsoliduar jemi bazuar në pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit për vitin 2021, raportin për zbatimin e buxhetit vjetor, raportin për borxhin publik dhe përbërjen e tij, raportin për përdorimin e fondit rezervë dhe kontigjencës, si dhe raportin për situatën e kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme të përgatitur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në fund majin e vitit 2022.

Nëpërmjet veprimtarisë kontrolluese, kemi audituar veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë, përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor, veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e aksioneve, si dhe huat, kreditë dhe detyrimet e tyre të cilat garantohen nga shteti.

Në funksion të hartimit të Raportit për zbatimin e buxhetit të vitit 2021, janë edhe rezultatet e auditimeve të kryera dhe të evaduara të përputhshmërisë, financiare, të IT-së, të performancës, si dhe auditime të kombinuara, mbi tërësinë e të ardhurave, shpenzimeve dhe financimeve të qeverisjes qendrore e vendore dhe të fondeve speciale, të cilat miratohen me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë ose me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, përfshirë dhe fondet publike të cilat mblidhen, arkëtohen, mbahen, shpërndahen e shpenzohen nga njësitë e sektorit publik dhe që përbëhen nga të ardhurat, shpenzimet, kreditë dhe grantet.

Raporti paraqet në mënyrë të përmbledhur dhe problematikat, mangësitë dhe të metat, e konstatuara në lidhje me çështje të planifikimit, monitorimit dhe zbatimit të buxhetit në auditimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në fondet speciale (ISSH dhe FSDKSH), si dhe institucione qendrore e të varësisë dhe entitete të tjera publike.

Për të përmirësuar përgjegjshmërinë publike, transparencën dhe llogaridhënien e qeverisë, KLSH do të mbështesë institucionet publike për të parandaluar, por edhe do të vijojë me identifikimin e mangësive, shpërdorimeve dhe shkeljeve në përmbushjen e rregullt të detyrës nga ana e zyrtarëve publikë, duke i shoqëruar me rekomandimet përkatëse, pasi në këtë mënyrë i shërbehet mos-përsëritjes dhe parandalimit, të cilat kushtojnë shumë më pak, se sa pasojat e keq-menaxhimit dhe të abuzimeve financiare.

Opinionioni dhe përfundimet e arritura në zbatimin e buxhetit faktik 2021 janë të bazuara në 121 auditime të kryera dhe të evaduara në vitin 2021 dhe janar - shtator 2022, nga të cilët: 26 auditime financiare, 47 auditime përputhshmërie, 41 auditime të kombinuara: financiare dhe përputhshmërie, 5 auditime IT dhe 2 auditime të performancës, që përfshijnë 131 subjekte.

Nga të dhënat e Raportit “Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2021” përgatitur nga MFE dhe të auditimeve të mësipërme rezultojnë se, të ardhurat totale të buxhetit të konsoliduar për vitin 2021 janë realizuar në vlerën 510,572 milion lekë, nga 507,727 milion lekë të buxhetit të planifikuar vjetor të rishikuar me Aktin Normativ (AN) nr.34, datë 03.12.2021, duke tejkaluar planifikimin me 2,845 milion lekë, pra realizuar në masën 100.6%, si dhe krahasuar me vitin e kaluar janë realizuar 84,667 milion lekë më shumë.

Të ardhurat e realizuara në buxhetin e vitit 2021 përbëjnë 28.8 % të PBB¹.

Shpenzimet janë kryer në vlerën gjithsej prej 595,968 milion lekë nga 628,269 milion lekë të buxhetit të rishikuar në dhjetor 2021 me Aktin Normativ nr.34, ose realizuar në masën 94.9%, me një mos realizim prej 32,301 milion lekë, si dhe krahasuar me vitin e kaluar janë kryer 11.1% më shumë shpenzime në vlerën prej 59,461 milion lekë, pavarësisht mosrealizimit të shpenzimeve të planifikuara të vitit buxhetor 2021.

Shpenzimet buxhetore të kryera në vitin 2021 përbëjnë 33.6% të Produktit të Brendshëm Bruto.

Sipas ligjit të buxhetit për vitin 2021, deficitin buxhetor fillimisht ka qenë 108,695 milion lekë dhe me Aktin Normativ nr.26, datë 22.06.2021 është ndryshuar në rritje në vlerën gjithsej prej 120,542 milion lekë, por gjithsesi më i ulët krahasuar me planifikimin e vitit 2020, që ishte 132,965 milion lekë. Sipas treguesve të konsoliduar fiskal të MFE dhe auditimit në këtë institucion, deficitin buxhetor për vitin 2021 ka rezultuar 85,397 milion lekë, pra është përdorur 71% e totalit të planit të ndryshuar, në një kohë që janë realizuar 95% e shpenzimeve të planifikuara të rishikuara, të cilat janë dukshëm më të përmirësuara se në vitin 2020, si rezultat i rritjes së nivelit të të ardhurave të grumbulluara. Në vitin 2021 financimi i deficitit buxhetor ka pësuar rënie në vlerën prej 25,205 milion lekë krahasuar me vitin 2020.

Duhet theksuar se buxheti i vitit 2021 është karakterizuar nga ndryshime të shumta gjatë vitit, të cilat fillojnë në muajin shkurt, 2 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit dhe mbylljen në më pak se një muaj para mbylljes së vitit buxhetor. *Përveçse të gjitha ndryshimet me akte normative deri në muajin korrik, proceduralisht duhet t'i nënshtroreshin dokumentacionit dhe afateve si në projektbuxhetin vjetor, numri i lartë i ndryshimeve tregon se buxheti fillestar mund të mos ketë qenë realist, duke lëkundur besueshmërinë e procesit të planifikimit, si pasojë e mangësive të kapaciteteve institucionale, pjesë të zinxhirit të planifikimit buxhetor.*

Nga analiza e përbërjes strukturore të të ardhurave buxhetore, gjithsej konstatohet se ato përbëhen nga ndihmat, të ardhurat tatimore si dhe të ardhurat jo tatimore.

Të ardhurat nga ndihmat janë realizuar në vlerën 12,671 milion lekë ose 65.5%, duke krijuar

¹ PBB e llogaritur sipas vlerësimit të FMN- World Economic Outlook (WEO) në shumën 1,769,258 milion lekë.

një mosrealizim prej 6,682 milion lekë, me gjithë planifikimin në ulje gjatë vitit dhe peshën e papërfillshme në të ardhurat gjithsej prej 2.5%. Ky mosrealizim është mbuluar me tejkalimin e dy zërave të tjerë: të ardhurat tatimore janë realizuar në vlerën 475,612 milion lekë ose 101.9% (të cilat zënë peshën kryesore prej 93%) dhe të ardhurat jo tatimore në vlerën 22,289 milion lekë.

Duke e konsideruar kuadrin makroekonomik fiskal dhe treguesit e tij të një rëndësie të veçantë në përcaktimin e përparësive strategjike të qeverisë dhe të synimeve dhe objektivave në lidhje me treguesit kryesorë të politikës fiskale, rezultojnë se vijon të mungojë saktësia në parashikimin e treguesve analitikë të të ardhurave në periudhë afat mesme dhe vjetore.

Nga analiza e ecurisë mujore e mbledhjes së të ardhurave gjatë vitit 2021 rezultojnë se në muajin shkurt është niveli më i ulët i të ardhurave të grumbulluara gjithsej dhe atyre tatimore dhe muaji dhjetor me nivelin më të lartë, me një rritje prej 40 -50% e tyre, *gjë që shfaq dhe punën jo sistematike të institucioneve të ngarkuara me mbledhjen e të ardhurave.*

Pjesë përbërëse e të ardhurave tatimore janë të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të ardhurat nga pushteti vendor dhe të ardhurat nga fondet speciale, të cilat në planin përfundimtar buxhetor kanë qenë në vlerën 466,773 milion lekë dhe janë realizuar 475,612 milion lekë ose në masën 102%, duke tejkaluar planin me 8,839 milion lekë.

Nga të dhënat rezultojnë me tejkalime në krahasim me të ardhurat e planifikuara tre grupzërat përbërës të të ardhurave tatimore, ndjeshëm më shumë se realizmi i tyre në vitin 2020. Megjithëse të ardhurat gjithsej nga tatimet dhe doganat janë tejkaluar, sipas zërave dhe nën zërave të tatimeve dhe taksave, *rezultojnë se nuk janë realizuar: TVSH brenda vendit për 11,075 milion lekë, tatimi mbi të ardhurat personale për 1,888 milion lekë dhe renta minerare për 1,455 milion lekë.*

Për të ardhura nga tatimet dhe doganat, të ardhurat nga TVSH, megjithëse janë realizuar në total 100.9%, *DPT nuk ka realizuar të ardhurat e planifikuara të rishikuara të TVSH neto për vlerën prej 10,959 milion lekë, për shkak jo vetëm të mos arkëtimit të të ardhurave nga TVSH e krijimit të detyrimeve të reja, por dhe tejkalimi i planit të rimbursimit me 42%, duke shtuar dhe faktin që me ndryshimet në rritje të vlerës së TVSH së arkëtuar, MFE ka mbajtur të pandryshuar nivelin e rimbursimit, duke ndikuar në thellimin e mosrealizimit.*

Krahasuar me vitin 2020, TVSH neto ka një rritje të papërfillshme, në një kohë që TVSH bruto ka një rritje të konsiderueshme të ardhurash prej 18%, për shkak të tejkalimit të ndjeshëm të rimbursimit të TVSH.

Megjithëse, DPT ka raportuar në MFE stokun e rimbursimit të TVSH në vlerën 476,650 mijë lekë, nga auditimi ka rezultuar se, në mbyllje të periudhës ushtrimore 2021, janë 69 kërkesa për rimbursimin e TVSH-së të pranuar, por të pa miratuara në vlerën totale për 1,893,609 mijë lekë, të cilave u ka kaluar afati maksimal prej 60 ditë nga data e paraqitjes së tyre dhe nuk janë rimbursuar. *Pra, në vlerësimin e KLSH, stoku i rimbursimit më 31.12.2021 është 2,370,259 mijë lekë, ose 1,893,609 mijë lekë më shumë se raportimi i DPT.*

Sipas raportit të MFE, tatimi mbi të ardhurat personale është realizuar 39,312 milion lekë ose me një mosrealizim prej 1,888 milion lekë, megjithëse janë mbledhur 6% më shumë se një vit

më parë.

Nga auditimi në DPT rezulton se taksat nacionale dhe të qarkullimit rrugor janë me një mos realizim prej 818 milion lekë.

Renta minerare në planin përfundimtar ka qenë 3,900 milion lekë dhe janë mbledhur 2,445 milion lekë, me një realizim prej 62.7%, duke krijuar një deficit në të ardhurat nga ky zë prej 1,455 milion lekë.

Nga auditimi në DPT është konstatuar se në përbërjen e të ardhurave faktike të vitit ushtrimor të strukturuar sipas natyrës dhe llojit të të ardhurave janë edhe të hyrat e kontabilizuara në llogarinë 466 “Mjete në ruajtje” e cila përfaqëson *arkëtimet e pidentifikuara (parapagime) me një detyrim në sistemin C@TS deri në sistemin e tyre në vlerën prej 27,217 milion lekë, shumë e cila ndikon në raportimin real të të ardhurave vjetore të mbledhura, si pasojë e parapagimeve nga ana e tatimpaguesit.*

Realizimi i të ardhurave doganore kundrejt planit të vitit 2021, në terma bruto rezulton në masën 106.7%, ose 12,115 milion lekë më shumë dhe në terma neto rezulton në masën 106.5%, ose 11,790 milion lekë më shumë se plani. Nga analiza e 60 grup artikujve kryesor, të cilët përbëjnë 89% të të ardhurave doganore *gjithsej, evidentohet se shtimi i të ardhurave është rezultat i rritjes së volumit të importeve në masën 75%, dhe i ndryshimit të të ardhurave për njësi në masën 25%.*

Në të ardhurat nga pushteti vendor, të cilat në total ishin planifikuar 25,926 milion lekë dhe janë realizuar 26,666 milion lekë, pra në masën 103%, nuk janë realizuar të ardhurat nga taksat lokale për vlerën 112 milion lekë, por që janë mbuluar me tejkalimin e të ardhurave nga tatimi mbi pasurinë dhe detyrimeve të prapambetura të tatimit mbi biznesin e vogël.

Nga auditimet e kryera nga KLSH në 51 njësi të vetëqeverisjes vendore, për aktivitetin e vitit buxhetor 2021, janë konstatuar shkelje me pasojë efekt negativ për të ardhurat e buxhetit të bashkive në vlerën 770.8 milion lekë, nga e cila: vlera 183.9 milion lekë nga mos zbatimi i ligjit për taksat dhe tarifatat vendore, 37.3 milion lekë nga keqadministrimi i pronës shtetërore, 259.9 milion lekë nga mos arkëtimi i gjobave dhe vlera 289.7 milion lekë nga shkelje të legjislacionit tatimor. Gjithashtu, është konstatuar se nuk janë marrë masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, duke krijuar të ardhura të munguara në Bashkinë Kukës, Lushnjë, Kavajë etj.

Stoku i borxhit tatimor për 36 bashki të audituara, për vitin ushtrimor 2021, është në vlerën 10,478.9 milion lekë, me rritje vjetore për vlerën 1,674.4 milion lekë.

Vijon të mbetet problem në disa bashki mungesa e ndërtimit të një sistemi tatimor të informatizuar dhe cilësor, me qëllim që të sigurojë evidentimin dhe administrimin e drejtë të të ardhurave, për të rritur nivelin e arkëtimit të të ardhurave të pushtetit vendor.

Për të ardhurat nga fondet speciale, megjithëse në total janë realizuar në masën 103%, është konstatuar se të ardhurat nga kontributi i sigurimeve shëndetësore nuk janë realizuar në vlerën 543 milion lekë dhe fondi i kompensimit të pronarëve për 269 milion lekë, ndërsa janë tejkaluar të ardhurat nga sigurimet shoqërore në vlerën prej 3,629 milion lekë.

Nga shqyrtimi i relacionit të projektbuxhetit të MFE për vitin 2021, rezulton se efekti i rritjes

së pagës minimale ishte parashikuar në 3 miliard lekë², gjë që tregon se rreth 83% e rritjes së të ardhurave të kontributeve shoqërore kanë ardhur si rezultat i këtij veprimi.

Nga auditimi i kryer në ISSH, ka rezultuar se në vitin 2021 numri i kontribuuesve gjithsej në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore është rritur me 42 960 persona, nga të cilët rreth 26% i përkasin sektorit shtetëror (buxhetor dhe jobuxhetor) kontribute që paguhën në pjesën më të madhe nga buxheti i shtetit, është ulur numri i kontribuuesve në subjektet private me 31 085 persona dhe janë rritur ndjeshëm të vetëpunësuarit.

Fakti që me Aktin Normativ nr.34, datë 03.12.2021 kontributet nga sigurimet shëndetësore janë planifikuar në rritje me 1,000 milion lekë krahasuar me ligjin e buxhetit dhe nuk janë realizuar, si dhe nga fakti që kontributet e sigurimeve shoqërore janë tejkaluar, tregojnë se ka pasur mungesë saktësie në planifikimin buxhetor për kontributet e sigurimeve shëndetësore.

Nga auditimet e kryera në DPT dhe DPD ka rezultuar se detyrimet e prapambetura tatimore, doganore dhe të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të subjekteve tatimpaguese në fund të vitit 2021, janë në vlerën gjithsej 180,646 milion lekë, me rritje vjetore neto prej 13,124 milion lekë (shtesa - pakësime), ose 7.3% të detyrimeve progresive të papaguara gjithsej.

Të dhënat tregojnë se stoku i detyrimeve të papaguara tatimore rritet me një ritëm më lartë se sa pakësohet (mblidhet), si dhe numri dhe vlera më e lartë e detyrimeve të papaguara ju përket subjekteve pasive, si dhe 80 % e borxhit i përket periudhave mbi 2 vjet, duke rritur dukshëm vështirësinë në mbledhjen e këtyre detyrimeve.

Duhet theksuar se e njëjta situatë konstatohet dhe në detyrimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ku niveli i borxhit në fund të vitit 2021 ishte 17,743.3 milion lekë, si dhe atyre doganore në vlerën 1,264.8 milion lekë me një trend rritës të numrit të debitorëve dhe nivelit të borxhit krahasuar me vitin 2020.

Mbledhja e të ardhurave të buxhetit në masën 94% është nën përgjegjësinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave me drejtoritë dhe degët rajonale të tyre.

Nga auditimi i kryer në *Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve*, kanë rezultuar 678 kontrole të pezulluara, të papërfunduara, ose të pafilluara, si dhe të mbartura që nga viti 2015 e në vijim, gjë që sjell për pasojë jo vetëm performancë të ulët të veprimtarisë kontrolluese duke humbur efektin e shqyrtimit dhe analizës së subjekteve tatimpaguese, por me ndikim dhe në nivelin e mbledhjes së të ardhurave tatimore.

Mundësitë e mbledhjes së të ardhurave tatimore janë akoma më të mëdha, po të mbajmë në konsideratë se numri i kontrolleve nga DRT për vitin 2021 e krahasuar me vitin paraardhës është realizuar në masën 81% ndërsa niveli i zbulimeve është në masën 45%, çka tregon për punën jo efektive në luftën kundër evazionit fiskal.

Nga auditimi në *Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave* ka rezultuar se plani përfundimtar i të ardhurave doganore të raportuara nga DPD, nuk është i njëjtë me planin e të ardhurave doganore sipas tabelës së treguesve të konsoliduar të buxhetit të shtetit, referuar Aktit

² Relacion mbi projektligjin "Për buxhetin e vitit 2021", faqe 12

Normativ nr. 34, datë 03.12.2021, për rrjedhojë analizat mbi realizimin e të ardhurave doganore nga vetë institucioni nuk janë kryer duke ju referuar planit të MFE.

Gjithashtu, nuk janë ndërmarrë aktivitete kontrolli shtesë për minimizimin e risqeve të cilat kanë ndikuar negativisht në rikuperimin e borxhit doganor, por përgjithësisht është mjaftuar vetëm në evidentimin e borxhit doganor të raportuar nga degët doganore, si dhe mungesë e burimeve njerëzore në ndjekjen e procedurave të vjeljes së borxhit.

Sipas treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar 2021, **shpenzimet gjithsej** janë realizuar në vlerën prej 595,968 milion lekë ose 94.9% me një mosrealizim prej 32,301 milion lekë. Shpenzimet buxhetore në pjesën më të madhe përbëhen nga shpenzimet korrente 461,075 milion lekë (77.3%), shpenzimet kapitale 98,203 milion lekë (16.5%), fondi i rindërtimit 29,521 milion lekë (4.5%) etj.

Krahasuar me vitin e kaluar janë shpenzuar 59,461 milion lekë më shumë ose në masën 11.1%, kryesisht në shpenzimet korrente 39,708 milion lekë, shpenzimet kapitale me 12,894 milion lekë, në fondet për rindërtimin 12,930 milion lekë etj.

Duhet theksuar që secili prej zërave kryesorë përbërës të totalit të shpenzimeve në treguesit e konsoliduar nuk është realizuar krahasuar me planifikimin buxhetor përfundimtar me Aktin Normativ nr.34, datë 03.12.2021. Kështu, shpenzimet korrente kanë mosrealizimin më të lartë prej 11,792 milion lekë, megjithëse është tejkaluar fondi i pagave në shpenzimet e personelit në vlerën prej 1,247 milion lekë, shpenzimet operative mirëmbajtje për 3,570 milion lekë, shpenzimet për fonde speciale për sigurime shoqërore dhe shëndetësor në vlerën 4,259 milion lekë, shpenzime të tjera sociale (në pagesën e papunësisë dhe bonusin e lindjeve) me 1,255 milion lekë etj.

Gjatë kryerjes së shpenzimeve në vitin 2021, nga auditimet e kryera në MFE dhe njësitë e tjera të qeverisjes së përgjithshme e shoqëritë publike kanë rezultuar problematika dhe mangësi në fazën e regjistrimit, monitorimit dhe realizimit të shpenzimeve, krahas dëmit ekonomik të shkaktuar dhe përdorimit pa efektivitet të fondeve publike.

Nga auditimi në MFE, ka rezultuar se plani i buxhetit të miratuar me Aktin Normativ nr. 34, 03.12.2021 krahasuar me atë të hedhur në SIFQ sipas treguesve fiskal ka diferenca në pothuajse tek të gjithë zërat e shpenzimeve, me një vlerë neto prej 13,999 milion lekë; ka një numër të lartë rialokimesh prej 2 560 budget ID; rishikime të shumta të fondeve buxhetore të kryera përgjatë gjithë vitit, ku rezultojnë rreth 2 517 projekte të rishikuar, me një ndryshim neto të fondeve disponibël prej 65,100 milion lekë, si dhe 348 regjistrimi i rialokimeve me data kontabile, efektive më të hershme (retrospektive).

Gjithashtu, janë evidentuar 16 projekte investimi me vlerë 406 milion lekë të cilat në ligjin buxhetor 2021 kanë përshkrimin "*Fond i ngrirë*".

Janë paguar detyrime të prapambetura në vlerën 10,065 milion lekë, të cilat përfaqësojnë rreth 14% të Investimeve Kapitale me Financim të Brendshëm të realizuara për vitin 2021, duke mos paraqitur drejtë treguesit e realizimit të investimeve publike, pasi janë përfshirë edhe fatura të cilat datojnë nga viti 2009.

Janë regjistruar plan pagesash në SIFQ në vitin e tretë (3) për 15 projekte, në shumën 1,900 milion lekë, pa plan pagese për vitin aktual, vitin e parë (1) dhe vitin e dytë (2). Regjistrimi

në këtë vit i këtyre projekteve të investimeve është kryer në kushtet e mungesës së fondeve buxhetore të miratuara për angazhime të ndërmarra në vitin aktual apo vitet e mëparshme buxhetore, pasi nuk është e mundur që angazhimet e ndërmarra me kontrata përkatëse, të mos parashikohet që të ekzekutohen përgjatë 2 viteve të ardhshme buxhetore.

Janë realizuar investime kapitale me financim të brendshëm në vlerën për 1,148 milion lekë, të regjistruara në SIFQ, të cilat nuk kanë plan buxheti të miratuar, ndërkohë që në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar janë raportuar të realizuara ndaj planit të buxhetit.

Janë nënshkruar kontrata pas datës 15 Tetor për investimet publike, në total 1033 kontrata, me vlerë totale të kontraktuar 40,311 milion lekë, ndërsa angazhimi për vitin 2021 rezulton 4,295 milion lekë.

Në lidhje me investimet publike rezultojnë edhe problematika të tjera në regjistrimin dhe monitorimin e projekteve si:

- Janë kryer rishikime në pothuajse të gjitha projektet e investimeve me financim të brendshëm, të cilat rezultojnë në uljen e buxhetit të kontratave të lidhura rishtazi, në projekte investimi në vazhdim, si pasojë e alokimit të buxhetit në projekte infrastrukturore në masën 20 %, pa kaluar më parë në PBA 2021-2023.

- Gjatë vitit 2021, projektet e investimeve janë paraqitur dhe miratuar në mënyrë të fragmentarizuar, duke krijuar një numër shumë të madh projektesh, gjë që e vështirëson monitorimin e tyre.

- Rialokimet e shumta, që shërbejnë për të krijuar hapësirë buxhetore për fillimin e projekteve të reja, kryesisht për programin e transportit rrugor dhe furnizimi me ujë dhe kanalizime;

- Si rezultat i alokimeve të fondeve nga ato ekzistuese për projektet e reja, krijohen kushte për lindjen e detyrimeve të prapambetura në këto investime, duke e detyruar qeverinë të ndërmarrë rregullimet buxhetore nëpërmjet akteve normative.

Problematikat e mësipërme tregojnë për mangësi të theksuara kryesisht, planifikimi të investimeve publike nga ana e institucioneve qendrore dhe vendore, me efekt presion për rritjen e borxhit publik, si pasojë e mosrespektimit të kufijve të miratuar për shpenzime në vitin buxhetor aktual dhe kufijtë e miratuar për vitet e ardhshme buxhetore

Nga auditimi i 8 projekteve me financime të huaja, janë konstatuar mangësi dhe shkelje me pasojë dëm ekonomik në shpenzime në shumën 8 milion lekë për likuidimin e punimeve të pakryera, si dhe përdorim pa ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë të fondeve publike në shumën 551 milionë lekë, si rrjedhojë e mangësive në drejtim të zbatimit të punimeve, konkretisht shtyrjes së afateve të zbatimit të kontratës, si dhe zgjidhjeve teknike jo të favorshme.

Referuar kuadrit makroekonomik fiskal, **Kontratat koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore**, përfshihen në risqet fiskale me impakt buxhetor.

Për vitin 2021 nga 13 kontrata koncesionare/PPP me mbështetje buxhetore, janë kryer pagesa për 12 prej tyre në shumën gjithsej prej 11,517.7 milion lekë me një realizim të shpenzimeve në nivelin prej 97.4% kundrejt planit. Nga ana e qeverisë është respektuar kufiri i pagesave deri në 5% të të ardhurave tatimore faktike të vitit 2020, pasi sipas përllogaritjeve rezultojnë

2.89%. Nga auditimi në MFE i pagesave për kontratat koncesionare/PPP është konstatuar se, janë kryer pagesa për vitet e kaluara në vlerën prej 292.6 milion lekë ose 2.5% e shpenzimeve gjithsej për to, të cilat përbëjnë risk të shtuar për krijimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe në një rast, detyrimet kontraktuale nuk rezultojnë të buxhetuara, dhe as të regjistruara si detyrim në SIFQ, (projekti i ndërtimit të shkollave në Bashkinë e Tiranës), veprim në kundërshtim me përcaktimet në udhëzimin standard të zbatimit të buxhetit.

Nga auditimi në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) lidhur me kontrata koncesionare “Për ofrimin e hemodializës” janë konstatuar faturime për shërbime të pakryera për 6 248 seanca që i përkasin vlerës prej 69.9 milion lekë, duke sjellë si pasojë efekt financiar për faturimin e shërbimeve të pa realizuara. Kjo vjen si rezultat i mangësive në hartimin e projeksioneve, të cilat nuk janë në përputhje me nevojat reale sipas qendrave për kryerjen e këtij shërbimi.

Për koncesionin/PPP “Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale” është konstatuar se shërbimi është marrë brenda vlerës së buxhetuar, por ka ndryshuar numri i instrumenteve në mënyrë të paargumentuar për disa prej seteve nga viti në vit; nuk ekziston një protokoll i saktë sipas ndërhyrjeve/seteve; ka një numër shumë më të madh diagnozash/ndërhyrje në krahasim me numrin e seteve të përdorura; për të njëjtat ndërhyrje/sete janë aplikuar tre nivele kompleksiteti etj., duke sjellë për pasojë vështirësi në monitorim, si dhe vështirësi në respektimin e tavanit buxhetor, me ndikim zhbancim në buxhet dhe kufizime në ndërhyrje për pacientët.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga FSDKSH për financimin e kontratës së koncesionit të Kontrollit bazë të popullsisë (check up) konstatohet se, ofrimi i këtij shërbimi ka rifilluar në vijim të urdhrin të MSHMS në datën 01.09.2021, duke paraqitur mbi realizim në krahasim me projeksionin për periudhën në vijim të vitit, por që me disa ndryshimin të bëra në këtë kontratë, ka kontribuar në uljen e kostos së këtij shërbimi, pasi këto raste i zbriten faturës së shërbimit mujor.

- Detyrimet e ndërsjella midis kompanive të sektorit energjetik janë një element i rëndësishëm i risqeve fiskale, të cilat në fund të vitit 2021 rezultojnë në vlerën 144.21 miliard lekë. Nga kjo vlerë, 36.88 miliard lekë janë detyrime të kompanive të këtij sektori ndaj MFE dhe 6.7 miliard lekë detyrime të OSHEE ndaj DPT. Detyrimet e ndërsjella midis OSHE dhe OST, variojnë nga 13.9-17.8 miliard lekë. Niveli i lartë i detyrimeve të ndërsjella midis kompanive të sektorit energjetik dhe mungesa e këtij rakordimi përbëjnë risk të shtuar për buxhetin e shtetit.
- Detyrimet e akumuluar të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve deri në dhjetor 2021 rezultojnë të jenë në vlerën 21.9 miliard lekë, ku vetëm ndërmarrja e UK SHA Durrës ka 6.71 miliard lekë të këtyre detyrimeve. Vështirësitë financiare të këtyre ndërmarrjeve përbëjnë një risk të shtuar për shkak të nevojës për mbështetje buxhetore, me qëllim frenimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.
- Për njësitë e qeverisjes së përgjithshme, detyrimet e prapambetura deri në fund të vitit 2021 evidentohen në shumën 13.33 miliard lekë, me një ndryshim në pakësim krahasuar me vitin 2020 në vlerën rreth 1 miliard lekë. Duhet theksuar se ky raportim nuk paraqitet i saktë dhe i plotë nga MFE, pasi nga auditimi i pagesave për detyrimet

e prapambetura sipas të dhënave në SIFQ rezultojnë 1.2 miliard lekë më pak se pagesat e raportuara, vlerë kjo që i përket 359 institucioneve buxhetore.

- MFE nuk përfshin në raportimin e detyrimeve të prapambetura detyrimet e shtetit shqiptar nga vendimet Gjykatave të Arbitrazhit dhe Gjykatës së të Drejtave të Njeriut. Sipas raportit të MFE të mes vitit 2021 “Mbi zbatimin e buxhetit 2021”, “*Vlerësimi i situatës makroekonomike fiskale dhe buxhetore për 5 mujorin 2021 dhe pritshmëritë për 12 mujorin*”, detyrimi total i akumuluar për Arbitrazhet Ndërkombëtare për periudhën janar-qershor 2021 paraqiten në vlerën prej 155,712,905 euro. Të dhënat e mësipërme, si dhe ato të përditësuara në fund të vitit 2021, lidhur me detyrimet e vendimeve të Arbitrazhit Ndërkombëtar, nuk janë paraqitur në Raportin e Këshillit të Ministrave, përgatitur nga MFE, “*Mbi zbatimin e buxhetit vjetor, situatën makroekonomike dhe fiskale gjatë vitit 2021*”.

Fondi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019, në ligjin e buxhetit është planifikuar në vlerën 28,000 milion lekë, ndërsa me Aktin Normativ nr.34, datë 03.12.2021, ky fond është shtuar me vlerën 7,000 milion lekë, duke arritur në shumën 35,000 milion lekë. Rezulton se fondi i rindërtimit është realizuar në shumën 29,521 milion lekë, ose në masën 84.4%, nga të cilat, shpenzimet për qeverisjen qendrore përbëjnë 39% të realizimit, ndërsa shpenzimet e qeverisjes vendore 61%.

Parashikimi në nenin 7, të ligjit nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” të fondeve të rindërtimit për njësitë e qeverisjes vendore duke shtuar kufijtë e transfertës së pakushtëzuar, nuk është në përputhje me përcaktimet e ligjit “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pasi midis të tjerave, transfertat janë pa kusht, ndërkohë, që këto janë të kushtëzuara në akordimin e fondeve për rindërtimin e objekteve të cilët kanë pësuar dëmtime nga tërmeti, duke cenuar edhe formulën e shpërndarjes së tyre.

Nga auditimi në MFE është konstatuar, se vlera e fondeve prej 30,573 milion lekë, të shpërndara me VKM deri në fund të vitit 2021, është mbi vlerën e përcaktuar në ligjin e buxhetit të vitit 2020 dhe 2021 të marrë së bashku për fondet e parashikuara të rindërtimit, pasi fondet e planifikuara janë në shumën 67,000 milion lekë, ndërsa me VKM janë shpërndarë gjithsej 97,573 milion lekë.

Gjithashtu, rezulton se, disa VKM kanë përcaktuar si burim financimi edhe ngurtësimin e fondeve nga projektet e rindërtimit me ecuri të ngadaltë, në shumën 4,468 milion lekë. Përdorimi i ngurtësimit të fondeve për këtë qëllim, nuk është i mbështetur në kritere ligjore, pasi në ligjin organik të buxhetit dhe ligjin vjetor të buxhetit nuk parashikohet ngurtësimi, si mënyrë për rialokimin e fondeve.

Për vitin 2021, shpenzimet operative për strehimin e familjeve, shtëpitë e të cilëve janë dëmtuar nga tërmeti, rezultojnë në shumën 2,985 milion lekë, ose 61 milion lekë më shumë se në vitin 2020, duke rritur më tej koston totale të procesit të rindërtimit.

Fondi rezervë në ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” ishte parashikuar 4,000 milion lekë dhe me katër Akte Normativ është ndryshuar në vlerën përfundimtare 9,000 milion lekë, duke respektuar kufirin ligjor përkatës deri në 3% vlerës totale të fondeve të miratuara. Me përdorimin e 1,000 milion lekë për përballimin e koston së zgjedhjeve për

Kuvendin, pjesa e tjetër prej 8,000 milion lekë është përdorur në vlerën prej 7,745.3 milion lekë ose 96.8 % nëpërmjet 30 VKM, nga i cili 54.7% nga MSHMS, 19.2% nga MFE etj. Destinacioni i përdorimit të fondit rezervë ka qenë 87.4% shpenzime korrente (shpenzime operative dhe transferta të brendshme) dhe vetëm 9.2% për investime.

Nga auditimi në MFE, është konstatuar se, akordimi dhe përdorimi i fondit rezervë për të financuar shpenzime të paplanifikuara operative dhe të investimeve, si dhe pagesa të prapambetura të institucioneve buxhetore ka devijuar nga parimi i përgjithshëm i qëllimit të këtyre fondeve për amortizimin e ngjarjeve të papritura si fatkeqësi natyrore, etj., duke sjellë për pasojë denatyrim të përdorimit të fondit rezervë.

Deficiti buxhetor në ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” ka qenë planifikuar 108,695 milion lekë dhe është ndryshuar me Aktin Normativ nr.26, datë 22.06.2021 me një rritje prej 11,848 milion lekë dhe plan përfundimtar vjetor prej 120,543 milion lekë, shumë e cila përbën 6.8% të PBB.

Ligji nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i miratuar më datë 16.11.2020, për deficitin e përgjithshëm nuk ka respektuar kufirin e deficitit të përgjithshëm buxhetor deri në 2% të PBB të përcaktuar në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 4/1, pika 1.d, por e ka parashikuar mbi 3-fish më të lartë. Kjo pasi ligji nr. 86/2021, për miratimin e Aktit Normativ nr. 25, datë 22.06.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” është miratuar më datë 01.07.2021, pra mbi 7 muaj pas miratimit të ligjit buxhetor fillestar.

Deficiti buxhetor në fund të vitit 2021 ka rezultuar 85,397 milion lekë, i cili përfaqëson 4.5% të PBB. Pavarësisht se, janë respektuar tavanet e ekzekutimit të deficitit buxhetor gjatë vitit, duhet theksuar se ai ka arritur nivelin prej 61.5% të tij në muajin dhjetor, për shkak se 44% e shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm janë kryer në këtë muaj, duke komprometuar përdorimin me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike, nga përqendrimi i përdorimit të tyre në fund të vitit.

Në raportin e buxhetit faktik për vitin 2021 të hartuar nga MFE është raportuar se **stoku i borxhit publik** ndaj PBB ishte në nivelin e 73.2% në vitin 2021, nga 74.5% në vitin 2020. Nga analiza, rezulton se, rënia e treguesit të borxhit publik në raport me PBB ka ardhur kryesisht nga dy faktorë si: rënia e borxhit të pushtetit lokal dhe norma e rritjes së PBB-së më e madhe se rritja e stokut të borxhit publik. Kështu, ritmi vjetor i rritjes së PBB-së është më i madh se borxhi, por vetë borxhi rezulton me rritje në vlerë prej 158,506 milion lekë ose me rreth 13% më shumë se viti 2020.

Gjatë vitit 2021 nuk janë emetuar bono thesari 6-mujore për mbulimin e humbjeve nga kursi i këmbimit në shumën 6.9 miliard lekë me efekt në nënvlerësimin e stokut të borxhit real të raportuar në fund të vitit 2021.

Gjithashtu, është konstatuar se, pagesat e principalit dhe interesave për garancitë jo performuese kryhen nga Buxheti i Shtetit, pa u marrë të gjitha masat e nevojshme nga ana e institucionit huadhënës për rikuperimin e detyrimit, por vetëm bazuar në vet-deklarimin e përfituesit të garancisë mbi paaftësinë paguese të tij.

Nga auditimi në MFE, është konstatuar krijimi i detyrimeve të reja në shumën 6,511 milion lekë të subjekteve nën-huamarrës në kuadër të marrëveshjeve të nën-huasë përgjatë vitit 2021, si pasojë e mos shlyerjes së detyrimeve përkatëse.

Garancitë shtetërore paraqesin një risk të shtuar në drejtim të administrimit të tyre, ku pothuajse e gjitha ulja e stokut të garancive të huaja i atribuohet pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit. Gjatë vitit 2021 janë krijuar detyrime të reja në shumën 1,529 milion lekë në kuadër të dështimit të pagesave për kreditë e garantuara nga përfituesi i garancisë, pa përfshirë efektin e garancive të dhëna në kuadër të projektit me numër identifikimi në regjistrin e kredive “88” në vlerën 403.9 milion lekë, duke sjellë për pasojë që rritja vjetore të vlerësohet në shumën 1,932.9 milion lekë.

Nga sa më sipër rezulton se, me gjithë realizimin e treguesve buxhetorë të vitit 2021 dhe përmirësimet krahasuar me vitin e kaluar, procesi i buxhetimit vjetor, vijon të mbartë mangësi harmonizimi në drejtim të planifikimit afatmesëm dhe atij vjetor; në disa institucione publike janë shfaqur dobësi në performancën e zbatimit të buxhetit. KLSH, gjatë veprimtarisë audituese, ka evidentuar problematika dhe mangësi në zbatimin e buxhetit të vitit 2021 nga institucionet e qeverisjes qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe entet e tjera publike, si në fushën e të ardhurave ashtu edhe në atë të shpenzimeve, me pasojë dëm ekonomik dhe efekte negative në buxhetin e shtetit.

Referuar rezultatit të 121 auditimeve të kryera dhe të evaduara, që i përkasin vitit buxhetor 2021, të ardhura të munguara dhe dëm ekonomik gjithsej ndaj buxhetit të shtetit është konstatuar në vlerën 46,604 milion lekë.

Në fushën e të ardhurave i është shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm prej 46,327 milion lekë, e cila përfaqëson shkelje në zbatim të legjislacionit tatimor në masën 98% dhe pjesa e tjetër nga shkeljet në zbatimin e kodit doganor, nga shkeljet në zbatim të legjislacionit për taksat dhe tarifatat vendore etj.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, dhe në disa prej drejtorive rajonale dhe degëve doganore janë konstatuar mangësi dhe të meta, të cilat kanë sjellë për pasojë të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, si pasojë jo vetëm e numrit dhe cilësisë së ulët të kontroleve tatimore, por ashtu edhe nga vlerësimi doganor, gjë që nxjerr në pah dobësinë e kapaciteteve institucionale të ngarkuara për këtë qëllim.

Dëmi ekonomik për buxhetin e shtetit në fushën e shpenzimeve ka rezultuar 277 milion lekë, kryesisht në fushën e investimeve 92%, por edhe në shpenzimet operative, në projektet me financim të huaj, etj.

Nga auditimet kanë rezultuar efekte negative në buxhetin e shtetit në vlerën 38,295 milion lekë, nga të cilat 1,525 milion lekë në të ardhurat e buxhetit (kryesisht në zbatimin e kodit doganor dhe në taksat dhe tarifatat vendore) dhe 36,769 milion lekë në shpenzimet buxhetore (në pjesën më të madhe në zërin e tjera shpenzime për vendimet gjyqësore për largime të paligjshme nga puna, si dhe në zbatimin e investimeve).

Krahas sa më lart, KLSH, në vitin 2021 dhe më parë, nëpërmjet auditimeve të teknologjisë së informacionit i ka trajtuar çështjet e informatizimit jo thjeshtë dhe vetëm në kuadër të mungesës së strategjisë dhe akteve rregullative për sistemet e ngritura, por ka theksuar

vazhdimisht pamjaftueshmërinë në garantimin e sigurisë së të dhënave, si dhe vazhdimësinë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet Teknologjisë së Informacionit, si në AKSHI, APP, ASHK, AKU, ISUV etj., me qëllim marrjen e masave në këto drejtime.

Çështjet e **menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm** janë konsideruar të rëndësishme nga ana e KLSH, duke i përcaktuar në drejtime të veçanta të auditimeve, pasi mundësojnë menaxhimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, nëpërmjet një sistemi politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh për planifikimin, drejtimin dhe kontrollin e burimeve financiare.

Bazuar në Raportin “Mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2021”³ si dhe në auditimet e kryera nga KLSH arrihet në konkluzionin se, vijon të mungojë angazhimi i duhur për përmirësimin e nevojshëm dhe të domosdoshëm në këtë drejtim, pavarësisht se zbatimi i një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe të kontrollit është detyrim ligjor i njësisë të qeverisjes së përgjithshme, shoqërive tregtare, si dhe e çdo njësie që shpenzon fonde publike.

Nga pesë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, konstatohet se me përjashtim të mjedisit të kontrollit dhe të informacionit të komunikimit, të cilat vlerësohen me rezultate mesatare, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit dhe të monitorimit, vazhdojnë të vuajnë nga probleme të shumta dhe nuk kanë prirje përmirësimi.

Veprimtaria e auditit të brendshëm në sektorin publik cilësohet se ka një progres të moderuar por vijon të jetë larg pritshmërive dhe me sfida thelbësore teknike dhe profesionale. Fakti që për vitin 2021 janë 42 ente publike (19 institucione të pavarura, 13 agjenci dhe 10 bashki) që nuk janë të mbuluara me auditim të brendshëm në asnjë nga format e përcaktuara në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator, të cilat përbëjnë ¼ e të gjitha institucioneve për auditim, tregon se mungon mbikëqyrja e sistemeve të kontrollit, dhe për pasojë nuk ka asnjë lloj sigurie se menaxhimi financiar i fondeve publike kryhet në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator dhe se përdorimi i tyre bëhet me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet.

Veç kësaj, strukturat e auditimit të brendshëm rezultojnë me mungesë për 52 pozicione audituesi ose 25%, duke vijuar në të njëjtat problematika si në vitet e kaluara. Nga vlerësimet e jashtme të cilësisë të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik rezulton se shfaqin dobësi si në krijimin e strukturave të auditimit të brendshëm ashtu edhe për rekrutimin e audituesve, zbatimin e standardeve të auditimit të brendshëm etj., kryesisht në nivel lokal dhe në qendrat spitalore.

Parregullsitë e evidentuara në zbatimin e ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dëmet ekonomike dhe mungesa e përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet e fondeve publike të rezultuara nga auditimet, të shoqëruara me mangësi të theksuara në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, tregojnë se mbetet shumë për të bërë në drejtim të mirë menaxhimit të financave publike.

Duhet theksuar që KLSH, për çdo auditim, sipas rastit ka evidentuar përgjegjësitë për

³ Raport mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme për vitin 2021” të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, maj 2022

moszbatimin e legjislacionit buxhetor në tërësi, si dhe ka kërkuar ndëshkimin e zyrtarëve përgjegjës sipas nivelit të përfshirjes në parregullsitë dhe mangësitë e rezultuara, me synim rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, eficiencës dhe disiplinës fiskale në planifikimin dhe shpenzimin e fondeve publike.

Të nderuar deputetë, anëtarë të Komisionit për Ekonominë dhe Financat,

Në mënyrë të detajuar, të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e buxhetit të vitit 2021, janë paraqitur në Raportin për zbatimin e buxhetit të vitit 2021, depozituar në Kuvend me shkresën nr.623/1 prot., datë 10.10.2022, në plotësim të detyrimit ligjor që raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit miratohet nga Kuvendi brenda muajit tetor, si dhe të kërkesës Tuaj nr.839 prot., datë 13.09.2022, për dërgimin e këtij raporti brenda datës 10 tetor 2022.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përmbushje të detyrimit kushtetues dhe misionit të tij, bazuar në rezultatet e auditimeve për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2021, nëpërmjet rekomandimeve të dhëna konsideron çështje kyçe që kërkojnë vëmendje të shtuar nga ana e Qeverisë në të ardhmen:

- *Së pari*, Përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të planifikimit buxhetor afat mesëm dhe atij vjetor për t'i harmonizuar midis tyre, si dhe për të siguruar saktësi dhe cilësi në zbatimin e prioriteteve strategjike, garantimin se ndryshimet e buxhetit vjetor i nënshtrohen dokumentacionit dhe afateve siç përcaktohet në ligjin që menaxhon këtë sistem, me synim një buxhet vjetor realist, të mirë-balancuar e të qëndrueshëm, me një raport të ulur të borxhit publik;

- *Së dyti*, Rritja e të ardhurave buxhetore nëpërmjet uljes së informalitetit dhe zgjerimit të bazës së tatimpaguesve; arkëtimit të detyrimeve të prapambetura tatimore dhe doganore, duke forcuar institucionalisht administratën fiskale, me pasojë zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe prirje të reduktimit të borxhit publik;

- *Së treti*, Mirë-menaxhimin e vazhdueshëm të projekteve të investimeve publike, me qëllim rritjen e efektivitetit, eficiencës dhe economicitetit në përdorimin e fondeve buxhetore, në funksion të uljes së kostos dhe rritjes së cilësisë së shërbimit dhe përmirësimit të jetesës së qytetarëve;

- *Së katërti*, Sigurimin e angazhimit të nevojshëm dhe të domosdoshëm në funksionimin dhe përmirësimin e zbatimit të një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, nga ana e njësisë të qeverisjes së përgjithshme, shoqërive tregtare si dhe e çdo njësie që shpenzon fonde publike.

Në përfundim, dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj dhe të Qeverisë disa çështje të vlerësuara të rëndësishme dhe nga institucione ndërkombëtare të auditimit, të cilat mund të kenë ndikim afatgjatë në zhvillimet e vendit tonë, në varësi edhe të mjedisit të jashtëm rajonal e global, me kërkesa thelbësore dhe presion të shtuar në financat publike, që duhet të mbahen në konsideratë për të ardhmen:

- Zhvillimet e sigurisë kibernetike me aftësinë për të ndarë, ruajtur dhe analizuar të dhënat shtetërore, me qëllim mbrojtjen nga përdorimi i paautorizuar dhe zhvillimet e orientuara të teknologjisë së informacionit për t'u siguruar që sistemet funksionojnë siç duhet dhe kërkohet;
- Aspektet e lidhura me pasiguritë dhe sfidat e jashtëzakonshme të sektorit publik, rishikimin e përparësive strategjike, dhe elementeve përbërës të skemës buxhetore nga kërcënimet e mundshme të lidhura me pushtimin rus të Ukrainës;
- Rishikimin e modeleve të partneritetit publik/privat për raportet midis tyre për ndarjen e qartë të risqeve, veçanërisht atyre fiskale, për të siguruar përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve dhe me kosto efektive;
- Çështjet globale të lidhura me pandeminë Covid-19, kanë të ngjarë të vijojnë të mbeten një prioritet i rëndësishëm për të ardhmen, me presionin mbi financat publike, për t'iu përgjigjur në kohë dhe me efikasitet situatave të tilla të fatkeqësive natyrore;
- Monitorimin e performancës së institucioneve shtetërore, në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të shpallura nga OKB, ku kërkohet të përshtaten ndikimet që kanë ndryshimet klimatike me nevojën për të investuar në infrastrukturë, për parandalimin e çështjeve të tilla si, tërmetet, përmytjet etj.

Ju faleminderit për vëmendjen!